



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1232 Prot.

Tiranë, më datë 03.08.2021

**VENDIM**  
**Nr. 513, datë 03.08.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.08.2021:

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Rikonstrukcion Objekt Ekzistues 2 Kate + Nënçati”, brenda kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës, me aplikues dhe projektues restaurator Z. Zef Çuni, zhvillues Z. Anton Vata:
  - Të propozohet një variant më i thjeshtëzuar i fasadës kryesore, duke pakësuar elementët dekorativë me qëllim që kjo ndërhyrje të ketë impakt minimal në lidhje me objektet përreth, pjesë e Qendrës Historike e qytetit të Shkodrës.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Arta DOLLANI**

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**